



# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15.07.2016

Ref.: 632/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 43-të, të mbajtur më 06 Korrik 2016, mori:

### V E N D I M

I. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" për periudhën tre vjeçare 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:

- Programi Parashkollor, BA, 240 ECTS, (maksimum 150 studentë për vit akademik);
- Programi Fillor, BA, 240 ECTS, (maksimum 200 studentë për vit akademik);
- Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, MA Profesional, 60 ECTS, (maksimum 30 studentë për vit akademik);
- Mësimdhënie në Shkencat Sociale, MA Profesional, 60 ECTS (me specializime: Histori; Histori-Edukatë Qytetare), (maksimum 30 studentë për vit akademik);
- Mësimdhënie në Teknologji dhe TIK, MA Profesional, 60 ECTS, (maksimum 30 studentë për vit akademik);
- Mësimdhënie në Matematikë, MA Profesional, 60 ECTS, (maksimum 30 studentë për vit akademik);
- Mësimdhënie në Shkencat Natyrore, MA Profesional, 60 ECTS, (maksimum 30 studentë për vit akademik);
- Udhëheqja në Arsim, MA, 90 ECTS, (maksimum 30 studentë për vit akademik);
- Mësimdhënia dhe Kurrikulat, MA, 90 ECTS, (maksimum 30 studentë për vit akademik);

- II. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.
- III. Obligohet Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri me 1 tetor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- IV. Obligohet Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri me datë 1 tetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

### Ar sy e t i m i

Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në vijim:

| Nr. | Programi i studimit                     | Niveli | ECTS | Bartësit e Programit                                     |
|-----|---|--------|------|--|
| 1   | Programi Parashkollor                   | BA     | 240  | Arlinda Thaci Beka, Atdhe Hykolli, Haki Xhakli           |
| 2   | Programi Fillor                         | BA     | 240  | Hatixhe Ismajli, Adhurim Rasimi, Myrvete Dreshaj-Baliu   |
| 3   | Mësimdhënie në gjuhë dhe letërsi shqipe | MA     | 60   | Begzad Baliu, Naser Pajaziti, Xhavit Beqiri              |
| 4   | Mësimdhënie në shkencat sociale         | MA     | 60   | Bahtije Zylfiu Gërbeshi, Sedat Baraliu, Minevere Rashiti |
| 5   | Mësimdhënie në Teknologji dhe TIK       | MA     | 60   | Kastriot Buza, Sylejman Berisha, Islam Krasniqi          |
| 6   | Mësimdhënie në matematikë               | MA     | 60   | Eda Vula, Xhevat Krasniqi, Fahri Marevci                 |
| 7   | Mësimdhënie në shkencat natyrore        | MA     | 60   | Zeqir Shaqiri, Fatlume Berisha, Arlinda Damoni           |
| 8   | Udhëheqja në arsim                      | MA     | 90   | Ethem Çeku, Blerim Saqipi, Valbone Berisha               |
| 9   | Mësimdhënia dhe kurrikulat              | MA     | 90   | Zeqir Veselaj, Naser Zabeli, Qazim Elshani               |

AKA ka organizuar vizitën në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” më 03.06.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Erwin Bratengeyer, Prof. Dr. Volker Frederking, Prof. Dr. Josep Maria Duarte, Prof. Dr. Milan Pol.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 06 Korrik 2016 ka vlerësuar aplikacionin e Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë